



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Tiranë më 30.08.2024

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
GUSHT 2024

1.	26.07.2024	Në vijim të bashkëpunimit me të gjitha institucionet shtetërore dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkojmë të dhëna nëse	31.07.2024	Nga kontrolli i të dhënave në regjistrin kombëtar të lejeve, autorizimeve dhe licencave të lëshuara nga QKB-ja rezulton si më poshtë vijon: Subjekti N***** shpk me disponon Leje Mjedisi Tipi B me emërtim përshkrues veprimtarie "Leje mjedisore për karrierë guri" dhe me vend kryerje veprimtarie Vlorë, Kotë, Drashovicë, Kallafet. Bashkëngjitur kopja e lejes mjedisore dhe akt - miratimi	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	------------	--------

		<p>subjekti N**** sh.p.k i cili operon brenda territorit të Bashkisë Selenicë dhe kryen aktivitetin e nxjerrjes të gurit gëlqeror, a i ka aktive lejet mjedisore dhe minerale për të ushtruar aktivitetin e shfrytëzimit ?</p> <p>Nëse po, lutemi na vini në dispozicion një kopje të këtyre lejeve mjedisore.</p>				
2.	05.08.2024	Në lidhje me aplikimin e subjektit "K**** E*****"	08.08.2024 (system 09.08)	AKM morri në shqyrtim aplikimin e subjektit "K**** E***** Shqiptare" sh.a aplikimi datë 18.01.2023 në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin "Hidrocentrali I Skavicës" me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjekti është refuzuar automatikisht nga sistemi e-leje pas tejkalimit të afatit ligjor. Subjekti "K**** E*****"	Përfunduar	Nuk ka

	<p>Shqiptare” sh.a aplikimi, datë 18.01.2023 në lidhje me procedurën për njoftimin të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës” me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit e cila është refuzuar automatikisht nga sistemi i elejeve pas tejkalimit të afatit ligjor, desha të dinëse :</p> <p>1.subjekti K*** ka riaplikuar për kryerjen e procedurës</p>	<p>Shqiptare” sh.a nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së të Thelluar.</p>		
--	---	---	--	--

		së VNM-së së Thelluar 2.Nëse po, mund të më nisni dokumentat përkatëse të aplikimit				
3.	09.08.2024	Kjo është një kërkesë për informacion lidhur me trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin mjedisor. Kjo kërkesë mbështetet në Nenin 23 të Kushtetutës; nenin 3 dhe 7 të Ligjit "Për të Drejtën për Informim"; neni 6 i	22.08.2024	<p>Sa më sipër ju bëjmë me dije se në bazë të informacionit që disponojmë subjektet e pajisura me leje mjedisi: VAGEXCO dhe SELENICE BITUMI , nuk janë inspektuar më parë, por janë propozuar me datë 13.08.2024 për t'u bërë pjesë e programit të inspektimit për muajin Shtator 2024. ARGJIRO GROUP , nuk është inspektuar më parë, por do të propozohet për t'u bërë pjesë e programit të inspektimit për muajit në vazhdim, ku pas kryerjes së inspektimit përkatës do ju vihen në dispozicion dhe aktet nga procedurat e mbajtura.</p> <p>Ndërsa subjektet e tjerë për të cilët kërkohet informacion, rezultojnë të pa pajisura me leje mjedisi, të tipit A dhe B që kërkohen për zhvillimin e aktivitetit përkatës, sipas Regjistrat Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në faqen e internetit të QKB-së. Kështu që dalin jashtë kompetencave të institucionit tonë, bazuar në Urdhrin e Inspektoratit Qendrorë Nr. 29, datë 30.08.2023 <i>“Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për Inspektoratin Kombëtarë të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”</i>, Pika 3: <i>“..., reciprokisht inspektorët e AKM, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror edhe inspektoratin e IKMT, për kompetencë”</i>.</p> <p>Sa më sipër në bazë të kompetencave të DREJTORISË RAJONALE TË IKMT- SË, VLOREË dhe GJIROKASTËR, po ju përcillet kërkesa mbi informacionin e kërkuar, për dhënien e</p>	Përfunduar	Nukka

	<p>Kodit të Procedurave Administrative; neni 4 dhe neni 5 i Konventës së Aarhusit (Konventa për Qasjen në Informacion , Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Dhënien e Drejtësisë në Çështjet Mjedisore).</p> <p>Mbështetur në detyrimet e legjislacionit mjedisor, konkretisht në ligjin “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Nr. 9115, datë 24. 7. 2003, kërkoj si më poshtë,</p>	<p>informacionit/dokumentacionit brenda afateve të parashikuara ligjore, si institucione kompetente.</p>		
--	---	--	--	--

		<p>Lidhur me kompanitë e mëposhtëme (lista në fund), të cilat kanë detyrimin për të kryer procesin e monitorimit të shkarkimit të ujërave të ndotura, nëpërmjet inisiativës personale me shpenzimet e tyre, ju si Agjenci, a keni kryer ndonjë kontroll (gjatë tri viteve të fundit), për të verifikuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave të dorëzuara, pas procesit të monitorimit</p>				
--	--	---	--	--	--	--

	<p>(vetëmonitorimit)? Nëse po, të dhënat e cilave kompanive keni kontrolluar, si dhe një kopje të dokumenteve (raporteve, proces verbaleve) të përpiluara mbi rezultatet e kontroleve të ushtruara.</p> <p>Kompanitë në fjalë janë:</p> <p>1. “Herb life”, Tregtim dhe përpunim i bimëve medicinale; Fitore (Novoselë).</p> <p>2. “Fabrikë vaji”, Grumbullim, prodhim dhe tregtim vaji; Fitore</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>(Novoselë) 3. “Fasoneri, këpucë”;; Prodhim këpucësh, atletesh, sandalesh; Fitore (Novoselë) 4. “VAGEXO”;; Prodhim dinamiti; Kakavi (Gjirokastër 5. “Argiro Group” , , Shtypshkrime, Gjirokastër 6. “Alb-Ducros Tepelena”;; Prodhim aromash; Tepelenë. 7. “Selenice Bitumi”;; Nxjerrje dhe përpunim bitumi, Selenicë</p>				
4.	14.08.2024	1. Listën e plotë me	14.08.2024	Referuar kërkesës në lidhje me subjektet që disponojnë leje për prodhimin e çelikut ju informojmë si më poshtë vijon:	Përfunduar	Nuk ka

		<p>subjektet që disponojnë leje për prodhimin e celikut për vitin 2020.</p> <p>2. Listën e plotë me subjektet që disponojnë leje për prodhimin e celikut për vitin 2021.</p> <p>3. Listën e plotë me subjektet që disponojnë leje për prodhimin e celikut për vitin 2022.</p> <p>4. Listën e plotë me subjektet që disponojnë leje për prodhimin e celikut për vitin 2023.</p>		<p>Për vitin 2020, 2021, 2022, 2023 dhe deri në periudhën 31.07.2024 nuk është pajisur me leje të re mjedisore asnjë subjekt për veprimtarinë e prodhimit të çelikut.</p> <p>Nga kontrolli i të dhënave në regjistrin kombëtar të lejeve, autorizimeve dhe licencave të lëshuara nga QKB-ja, subjektet e pajisura me leje mjedisi për prodhimin e çelikut janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KURUM INTERNATIONAL me leje mjedisi me PN-3843-09-2016 2. DELIU-05 me leje mjedisi me PN-0620-08-2015 3. LARASHI 2005 me leje mjedisi me PN-3372-04-2012 <p>Lejet mjedisore janë të publikuara në regjistrin kombëtar të lejeve, autorizimeve dhe licencave të lëshuara nga QKB-ja. Për një informacion më të saktë ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të licencave dhe lejeve.</p>		
5.	14.08.2024	1. Sasinë e plotë të mbetjeve të	19.08.2024	Bazuar në Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve	Përfunduar	Nuk ka

		<p>prodhuara nga furrat e celikut, që janë deklaruar nga subjektet për vitin 2020.</p> <p>2. Sasinë e plotë të mbetjeve të prodhuara nga furrat e celikut, që janë deklaruar nga subjektet për vitin 2021.</p> <p>3. Sasinë e plotë të mbetjeve të prodhuara nga furrat e celikut, që janë deklaruar nga subjektet për vitin 2022.</p> <p>4. Sasinë e plotë të</p>		<p>të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, Vendimit Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar, si dhe Urdhërit të ministrit me nr.135, datë 16.04.2015 për “Miratimin e e mënyrës së administrimit të formatit të Regjistrit të transfertave individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ju bën me dije se, Bazuar në VKM Nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” pika 3 Tipat e mbetjeve në katalog në pikën 10 janë specifikuar “Mbetje nga proceset termike”, ndërsa në kodin 10 02 - Mbetje nga industria e hekurit dhe e çelikut - 10 02 Mbetje nga industria e hekurit dhe e çelikut - 10 02 01 Mbetje nga përpunimi i skorieve - 10 02 02 Skorieve e papërpunuar - 10 02 07 * Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme - 10 02 08 Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 07 - 10 02 10 Smerc nga mulliri - 10 02 11 * Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse që përmbajnë naftë - 10 02 12 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 11 - 10 02 13 * Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme - 10 02 14 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 13 - 10 02 15 Llumra dhe shtresa filtri të tjera - 10 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara Sasia e mbetjeve që janë deklaruar nga subjektet për vitin 2020-2023.</p>																									
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Kodi i mbetje s</th> <th></th> <th>Viti 2020</th> <th>Viti 2021</th> <th>Viti 2022</th> <th>Viti 2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10 02 02</td> <td>Skorie e papërpunuar</td> <td></td> <td>6622920</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>10 02 10</td> <td>Smerc nga mulliri</td> <td></td> <td>1529160</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>10 02 01/10 02 02</td> <td>Mbetje nga përpunimi i skorieve/Sko</td> <td></td> <td>21993540</td> <td>11174000</td> <td>10359000</td> </tr> </tbody> </table>	Kodi i mbetje s		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	10 02 02	Skorie e papërpunuar		6622920			10 02 10	Smerc nga mulliri		1529160			10 02 01/10 02 02	Mbetje nga përpunimi i skorieve/Sko		21993540	11174000	10359000					
Kodi i mbetje s		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023																								
10 02 02	Skorie e papërpunuar		6622920																										
10 02 10	Smerc nga mulliri		1529160																										
10 02 01/10 02 02	Mbetje nga përpunimi i skorieve/Sko		21993540	11174000	10359000																								

		mbetjeve të prodhuara nga furrat e celikut, që janë deklaruar nga subjektet për vitin 2023.			rie e papërpunuar						
				10 02 07*	Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme		2780000			8611000	
				10 02	Mbetje nga industria e hekurit dhe celiku	1350040	4510982	887942		78105	
				Total sasia (kg)		1350040	37436602	12061942		10437105	
6.	15.08.2024	Banoj në Tiranë. Kanali i ujrave të zeza të pallatit ngjitur me shtëpinë time derdhet në oborrin e shtëpisë sime pasi tubacionet janë të cara. Jam ankuar tek UKT disa herë.. Situata është alarmante pasi në pellgun me ujra të zeza mushkonjat	22.08.2024	<p>Në vijim të ankesës tuaj, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit Nr. 8584 Prot, datë 15.08.2024, ankesa në fjalë është jashtë fushës së veprimtarisë dhe komtetencës së AKM-së, referuar Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” të ndryshuar dhe të VKM Nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.</p> <p>Për zgjidhjen e problemit sugjerojmë: Referuar ligjit Nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Bashkiake dhe të Komunava", Ligjit Nr. 139/2015 "Për Qeverisjen Vendore", VKM-së Nr. 515, datë 17.07.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme, referojmë Komisaratin e Policisë të zonës përkatëse, Njësinë Administrative përkatëse, Bashkinë Tiranë, Policinë Bashkiake si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për marrjen e masave për trajtimin e kësaj ankese sipas legjislacionit në fuqi.</p>						Përfunduar	Nukka

		dominojnë ambientin.				
7. Nr. Prot 8608	16.08.20 24	1.Venddepozitimin e mbetjeve nga prodhimi i celikut për kompaninë “Kurum Internatinal” 2.Venddepozitimin e mbetjeve nga prodhimi i celikut për kompaninë “Deliu 05” 3.Venddepozitimin e mbetjeve nga prodhimi i celikut per kompaninë “Larashi 2005”	28.08.2024	Në përgjigje të shkresës me Nr.8024/149 Prot protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me lëndë "Kërkesë për informacioni për venddepozitimin e mbetjeve nga prodhimi i celikut" . Ju bëjmë me dije se vend depozitimet e mbetjeve janë brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria, e pajisur me leje mjedisi. Menaxhimi i mbetjeve, është i përcaktuar sipas tabelave në lejet mjedisore për “Manaxhimin e mbetjeve”. Bashkëlidhur lejet e mjedisit 1. Kurum International 2. Deliu -05 3. Larashi 2005	Përfunduar	Nuk ka
8.	17.08.20 24	1.Në lejen mjedisore të lëshuar nga MTM/AKM	30.08.2024	Subjekti "KURUM INTERNATIONAL" SH.A me aktivitet "Magazini i hekurishteve ose skrapeve të metalit që nuk përmban materiale te rrezikshme. Fonderi e metaleve ferrose. Përpunirni i metaleve ferrose me mullinj me rrula në të nxehtë.	Përfunduar	Nuk ka

		<p>, subjekti Kurum cfarë kodesh mbetjesh të rrezikshme prodhon? 2.Kush është kompania e cila ka lidhur kontratë me subjektin " Kurum" për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme? (sipas kodeve të mbetjeve që prodhon); 3.A ka paraqitur kompania transfertat 6 mujore për mbetjet e rrezikshme? Nëse po, për cfarë kod mbetjesh ka dorëzuar? 4.A është e licensuar kompania e cila ka lidhur kontratë</p>		<p>Prodhimi i gizës ose celikut, duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme" nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë, për periudhën 2020 - 2024 është inspektuar 3(tre) herë (2020, 2022, 2023). Në inspektimet e kryera objekt i inspektimit ka qënë zbatimi i kushteve të L/M, i fokusuar në veçanti në shkarkimet në ajër. Në inspektimin e fundit, i iniciuar nga zjarri i rënë në ambientet e fushës së skrapit, pasi u konstatua se mbetjet e skrapit ishin të padiferencuara, pra përveç hekurishteve në fushë kishte: automjete në fund të jetës të pademoluara, goma, bombola, bolier dhe frigorifer të pademoluara nga shtresa termoizoluese, ndaj subjektit u vendos masë administrative.</p> <p>Bashkëngjitur (në linkun më poshtë) po ju përcjellim procedurën inspektuese (2020, 2022, 2023), monitorimet e kryera (2020, 2022, 2023), kontratat e subjektit, si dhe procedurat inspektuese të kryera në një nga subjektet me të cilët subjekti ka kontratë për evadimin e mbetjeve industriale.</p> <p>https://nais-my.sharepoint.com/personal/festim_shemilli_akm_gov_al/_layouts/15/onedrive.aspx?id=%2Fpersonal%2Ffestim%5Fshemilli%5Fakm%5Fgov%5Fal%2FDocuments%2FKurum%20Info&ga=1</p> <p>Operatori “Kurum International”, është i pajisur me Leje Mjedisi Tipi A me aktivitet sipas: “ID 1.7 Gaz natyror aromatik ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur; ID 2.2 Prodhim i gizës ose çelikut (shkrirje primare dhe sekondare) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme; ID 2.3a) Pëpunim i metaleve ferrose-me mullinj me rula në të nxehtë; ID 2.4 Fonderitë e metaleve ferrose; ID 3.1b) prodhim i gëlqeres në furra rrotulluese ; ID 7.12 /k Përpunimi dhe saldimi i metaleve; me vendodhje: Ish Kombinati Metalurgjik, Njësia administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan”.</p>		
--	--	---	--	---	--	--

	<p>Kurum,për transportin dhe asgjësimin e kodeve të mbetjeve, nga AKM; 5.A janë kryer inspektime në subjekte të cilat asgjësojnë kodet e mbetjeve të Kurum? Nëse po,ju lutem më bashkëngjini një kopje të procesverbal -eve të inspektimit nga viti 2020 e në vijim; 6.A ka paraqitur subjekti Kurum raportet e vetmonitorimit ? Nëse po,ju lutem na vendosni një kopje të raporteve</p>		<p>Në Shtojcën 4.1 -Menaxhimi i mbetjeve, tabela 4.1.1 të lejes së mësipërme, tregohen mbetjet e rrezikshme që ky subjekt gjeneron sipas deklaramit përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> -10 02 07* mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme -10 02 11* mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë naftë -10 02 13* llumra dhe shtesa filtri nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substance të rrezikshme. <p>Për sa më sipër Operatori “Kurum International”, ka të përcaktuar në lejen e mjedisit se mbetjeve i kryet grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin përfundimtar të këtyre mbetjeve nga subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Të gjitha mbetjet që gjenerohen nga operatorë menaxhohen sipas përcaktimeve të ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar Referuar e-mailit tuaj, pika 6, në të cilën kërkohen Raportet e Vetëmonitorimit për subjektin "Kurum International", ju lutem do të gjeni në formatin CD Raportet për periudhën e kërkuar, e cila për shkak të volumit të lartë (MB) në e-mail nuk mund të bashkëlidhet por i gjeni në CD pranë zyrës së protokollit të AKM-së.</p> <p>Bazuar në regjistrat e transferimit të mbetjeve të vetëdeklaruar nga subjekti Kurum International, mbetjet e rrezikshme janë dorëzuar si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Për kodin 16 06 01* – CCALB shpk -Për Kodin 18 01 01/18 01 02/18 01 03*- Pura Medical -Për Kodin 10 02 07* - Alliance Resource shpk <p>Kompania ka paraqitur transfertat 6 Mujore të mbetjeve për kodet e mbetjeve të rrezikshme. Kodet e mbetjeve janë si më poshtë:</p>		
--	--	--	--	--	--

		<p>(nga viti 2020 e në vijim);</p> <p>7.Në të dhënat që disponon AKM, a është përfshirë kompania Kurum, në subjekt “ndotësi paguan”;</p> <p>8.A janë kryer inspektime në subjektin Kurum?</p> <p>Nëse po ju lutem na paraqesni një kopje të procesverbal -eve nga viti 2020 e në vijim;</p> <p>9.Cila është " ecuria e mbetjeve të rrezikshme" pasi sibjekti i transporton këto mbetje të rrezikshme?</p>	<p>16 06 01 – Bateri plumbi</p> <p>18 01 01/18 01 02/18 01 03*- Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)/ Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)/ Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet</p> <p>1. 02 07*- Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme</p> <p>Subjektet me të cilat janë kryer transfertat janë të pajisura me leje mjedisi.</p>		
--	--	---	---	--	--

9.	20.08.2024	Nisur nga konstatimet e Shërbimit Veterinar Berat mbi problematiken e hasur me gjenerimin e mbetjeve shtazore jo për konsum human gjatë therjeve të bagëtive të imta (kurbaneve) në pelegrinazhin e Besimtarëve Bektashinj në Malin e Tomorrit të cilat theren në dy pika therje dhe jashtë tyre është konstatuar se këto mbetje shtazore groposon. Këto pika nuk janë të liçensuara dhe	26.08.2024	<p>Në trajtim të denoncimit "Mbi menaxhimin e mbetjeve nga therrjet në pelegrinazhin e Besimtarëve Bektashinj në Malin e Tomorrit. Agjencia Rajonale Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë në datë 19.08.2024 ka kryer proces verifikim në Malin e Tomorrit në vendin ku ushtrohet pelegrinazhi i Besimtarëve Bektashinj, dhe konstatoi se : Në të gjithë territorin e zhvillimit të pelegrinazhit nuk ka operator që ushtron aktivitet therrje (kurban) të cilt janë të pajisur me leje mjedisore të tipit A apo të tipit B.</p> <p>Në zbatim të Urdhërit Nr. 29, datë 30.08.2003, të Inspektoratit Qëndror, "Për zbatimin e ligjshmerise dhe bashkërendimin në fushë veprimtarine inspektuese të mjedisit për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit", Pika 2 "Agjencia Kombëtare e Mjedisit., të ushtrojë veprimtarinë në fushën e pergjegjesisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në lejet mjedisore". Pika 3*Trupa inspektuese e IKMT, kur konstaton se operatori me leje mjedisore ka thyer kushtet e lejes mjedisore, të njoftoje pa vonesë Inspektoratin Qendror edhe për kompetencë Inspektoratin e AKM, reciprocikisht inspektorët e AKM, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qëndror edhe inspektoratin e IKMT, për kompetencë". Për sa më sipër duke marr në konsideratë se kemi të bjmë me ushtrim të një aktiviteti nga subjekte të cilat nuk janë të pajisur me leje mjedisore, në zbatim te pikës 3, Urdhërit Nr. 29, datë 30.08.2003, të Inspektoratit Qëndror, ja kemi përcjell për kompetencë trajtimin e çështjes Inspektoratit Kombtar të Mbrojtjes së Territorit, Dega Rajonale Berat.</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	------------	--------

		<p>gjithashtu nuk ka kompani Renderingu për marrjen dhe përpunimin e këtyre mbetjeve. Nisur nga ky fakt ne si shërbim veterinar nuk mund të kryejmë kontrole të mbetjeve shtazore jo për konsum human dhe për këtë arsye kërkojmë nga ana e institucioneve tuaja marrjen e masave per kete ndotje mjedisore.</p>				
10	21.08.2024	1.Cila është lista e mbetjeve të rrezikshme që aktualisht nuk lejohen	30.08.2024	1-Në bazë zbatim të nenit 48 “Ndalimi i importeve dhe kalimi transit i mbetjeve”, kreu IX “Importi dhe Eksporti i Mbetjeve” të ligjit 10 463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në Republikën e Shqipërisë ndalohet në të gjitha rastet importimi i mbetjeve të rrezikshme.	Përfunduar	Nuk ka

		<p>të importohen në Shqipëri?</p> <p>2.Cilat janë mbetjet e rrezikshme që prodhon vetë Shqipëria?</p> <p>3.Ku depozitohen aktualisht mbetjet e rrezikshme që prodhon vetë Shqipëria?</p> <p>4. Si bëhet përpunimi i mbetjeve të rrezikshme dhe cilat janë kompanitë që bëjnë përpunimin e tyre?</p> <p>5.Referuar projektligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (të hedhur</p>		<p>2-Bazuar në VKM-në Nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", janë të listuara të gjitha kodet e mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre.</p> <p>Sipas katalogut të mbetjeve janë 413 tipe mbetjesh të rrezikshme.</p> <p>3-Mbetjet e rrezikshme sipas Ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve trajtohen nëpërmejt procesit të rikuperimit, riciklimit dhe asgjësimit sipas metodave të ligjore të përcaktuara.</p> <p><i>"Rikuperim" është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që: a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoren në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar; b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.</i></p> <p><i>"Riciklim" është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t'i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse</i></p> <p>"Asgjësimit" është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.</p> <p>Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuara për asgjësimit ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuara për riciklim/trajtim.</p> <p>Lista e kompanive të cilat bëjnë përpunimin e mbetjeve është e afishuar pranë QKB-se.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		për konsultim publik), cila është lista e mbetjeve që do të lejohen për import?		4- Është dhënë në përgjigjen më sipër. 5- Është për ministrinë.		
11.	21.08.2024	1.Të na vini në dispozicion raportet e vetëmonitorimit të kompanisë Albpetrol për periudhën 1 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023.	02.09.2024	Në vijim të informacionit të kërkuar me shkresën Nr.8773 Prot datë 21.08.2024, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: lidhur me raportet e vetëmonitorimit të subjektit "Albpetrol" sh.a, se pas verifikimeve, rezulton se ky subjekt për të gjitha PN-të e kërkuara, ka dorëzuar raporte vetëm për vitin 2024. Për periudhat më përpara, nuk ka informacion, për sa kërkohet. Lidhur me faktin nëse AKM ka bërë njoftime për detyrimet e monitorimeve, drejtuar subjektit "ALBPETROL", ju bëjmë me dije se janë bërë në Gusht, 2023, për PN-6482-05-2018, PN-6621-06-2018, PN-6622-06-2018, PN-6733-07-2018, PN-6485-05-2018, PN-6484-05-2018 dhe PN-6483-05-2018.	Përfunduar	Nuk ka
12.	22.08.2024	1.Sa leje eksporti të mbetjeve janë dhënë nga Ministria e Mjedisit përgjatë viteve 2023 dhe 2024? 2.Për cilat destinacione	02.09.2024	<ul style="list-style-type: none"> Informacioni për përgjigjen e pyetjeve nga 1-3 ndodhet në MTM. Pyetja 4 <i>"Sa dhe cilat janë industritë që prodhojnë mbetjet të papërpunueshme në Shqipëri? Ku depozitohen këto mbetje?"</i> <p>Klasifikimi i mbetjeve bëhet sipas Ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe emërtimi sipas VKM-së Nr.402 datë 30.06.2021 " Për Miratimin e katalogut të mbetjeve" ku jepet lista e mbetjeve, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre. Në Katalogun e mbetjeve, nga 953 specifikime kodi</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p>janë dhënë këto leje?</p> <p>3. Sa është sasia e mbetjeve të eksportuara në vitet 2023 dhe 2024?</p> <p>4. Sa dhe cilat janë industritë që prodhojnë mbetje të papërpunueshme në Shqipëri? Ku depozitohen këto mbetje?</p> <p>5. Cilat janë dispozitat ligjore në lidhje me prodhimin, përpunimin dhe depozitimin e këtyre mbetjeve?</p>	<p>mbetje në total, 418 prej tyre klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim. Për kodet e mbetjeve të cilat nuk mund të trajtohen, riciklohen, ripërdoren apo asgjësohen në vendin tonë është e rregulluar dispozita ligjore për ti eksportuar në vendet të cilat i mundësojnë këto procese.</p>		
--	---	---	--	--

13.	22.08.2024	<p>A ka kjo agjenci raporte ose të dhëna se ku shkon hiri që prodhohet nga proceset e përpunimit të hekurit në metalurgjikun e Elbasanit? Ku depozitohet ky hi ? A trajtohet brenda Shqipërisë dhe si trajtohet? A ka kompani të licensuara për trajtimin e hirit që prodhohet nga djegia e metalit në metalurgjikun e Elbasanit? Sa herë në vit inspektohet metalurgjiku dhe kur ka qenë</p>	02.09.2024	<p>Të gjitha subjektet e pajisura me leje mjedisore kanë të përcaktuara në kushtet e lejeve përkatëse metodat e trajtimit të mbetjeve sipas kuadrit ligjor në fuqi Çdo mbetje klasifikohet sipas VKM Nr.402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve</p> <p>Sa i përket pyetjes mbi trajtimin e hirit, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Të gjitha subjektet e pajisura me leje mjedisore kanë të përcaktuara në kushtet e lejeve përkatëse metodat e trajtimit të mbetjeve sipas kuadrit ligjor në fuqi Çdo mbetje klasifikohet sipas VKM Nr.402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve</p> <p>Në lidhje me pyetjen sa herë është inspektuar metalurgjiku dhe kur ka qenë inspektimi i fundit nga AKM dhe cfarë ka rezultuar nga inspektim ju informojmë se:</p> <p>Subjekti "Kurum International" sh.a me aktivitet "Magazinimi i hekurishteve ose skrapeve të metalit që nuk përmban materiale te rrezikshme. Fonderi e metaleve ferrose. Përpunimi i metaleve ferrose me mullinj me rrula në të nxehtë. Prodhimi i gizës ose celikut, duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme" , është inspektuar cdo vit nga strukturat inspektuese të AKM-së. Inspektimi i fundit është kryer nëntor 2023 dhe objekt i inspektimit ka qenë zbatimi i kushteve të L/M, i fokusuar në veçanti në shkarkimet në ajër i iniciuar nga zjarri i rënë në ambientet e fushës së skrapit, pasi u konstatua se mbetjet e skrapit ishin të padiferencuara, pra përveç hekurishteve në fushë kishte: automjete në fund të jetës të pademoluara, goma, bombola, bolier dhe frigorifer të pademoluara nga shtresa termoizoluese, ndaj subjektit u vendos masë administrative me gjobë.</p>	Përfunduar	Nuk ka
-----	------------	---	------------	---	------------	--------

		inspektimi i fundit nga AKM? Cfarë ka rezultuar nga ky inspektim?				
14	23.08.2024	Lidhur me vendimin nr. 19 të komisionit (90) për shqyrtimin dhe monitorimin e lejeve mjedisore, i mbledhur në 17. 7. 2024, ku vendosi që projekti për mbrojtjen e argjinaturës së Lagunës së Karavastasë t’i nënshtrohet VNM Paraprake, i cili nuk ndodhet i publikuar në Regjistrin Kombëtar të	27.08.2024	<p>Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 828, datë: 28.12.2023, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM publikon listat e vendimeve dhe Deklaratat Mjedisore.</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj po ju përcjellim Vendimin e VNM Paraprake, dhe dokumentacionin e kërkuar.</p> <p>1. Mbështetur në pikën 2 të nenin 11 të ligjit “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, mbi argumentet dhe publikimin për procedurën paraprake të VNM-së, kërkoj,</p> <p>a) arsyet dhe konsideratat ku është mbështetur vendimi, Konsideratat janë të cituara në Vendimin e VNM-së Paraprake.</p> <p>b) mendimin e institucioneve të konsultuara Bashkëlidhur në e-mail keni dhe mendimet e dhëna për këtë aplikim.</p> <p>c) përshkrimin e masave që duhen marrë për të shmangur ndikimet negative të mundshme në mjedis.</p> <p>Në aktin e VNM janë vendosur kushtet shoqëruese të Vendimit dhe kushtet/masat që duhen marrë gjatë ndërtimit.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Licencave, Lejeve dhe Autorizimev e të lëshuara nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit, kërkoj, si vijon,</p> <p>1. Mbështetur në pikën 2 të nenin 11 të ligjit “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, mbi argumentet dhe publikimin për procedurën paraprake të VNM-së, kërkoj,</p> <p>a) arsyet dhe konsideratat ku është mbështetur vendimi</p> <p>b) mendimin e institucione</p>		<p>2. Përse ky vendim (VNM Paraprake) nuk i është kaluar QKL? Vendimet e VNM nuk publikohen në QKL pasi nuk janë as leje as Licencë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>ve të konsultuara</p> <p>c) përshkrimin e masave që duhen marrë për të shmangur ndikimet negative të mundshme në mjedis.</p> <p>2. Përse ky vendim (VNM Paraprake) nuk i është kaluar QKL?</p>				
15	22.08.2024	<p>Sa asgjësime të produkteve të skaduar ka kryer C***-C***Bottling Shqipëria shpk në vitin 2019 dhe 2020?</p> <p>Lutemi të na vendosni në dispozicion një kopje të</p>	29.08.2024	<p>Nga verifikimet e kryera në sistemin e-inspektimi për periudhën e kërkuar 2019-2020, për subjektin “C***-C*** Bottling”, nuk ka praktika asgjësimi të kryera.</p> <p>Pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër rezultojnë dy kërkesa për asgjësim nga shoqëria “C***-C*** Bottling”, konkretisht kërkesa e datës 28.07.20220 dhe 15.12.2020.</p> <p>Për këto kërkesa nuk ka procesverbale apo dokumente të tjera lidhur me zhvillimin e tyre, pasi në këtë periudhë institucionet (ISHMPUT është suprimuar nga AKM me VKM Nr.568/2019) kanë qënë në proces ristrukturimi dhe nuk i ka ndjekur praktikatat e asgjësimit.</p> <p>Ky informacion u përgatit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative I Republikës së</p>	Përfunduar	Nuk ka

		procesverbal eve të asgjësimit për periudhën e lartpërme- ndur.		Shqipërisë; Ligji Nr.10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së Nr.568/2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” së ndryshuar.		
16	26.08.20 24	1- Sa tonë mbetje të rrezikshme prodhon Shqipëria në vit? 2- Si trajtohen ose menaxhohen mbetjet e rrezikshme në Shqipëri? 3- A ka sot Shqipëria impian të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme? Nëse po ku ndodhet dhe me çfarë tarifash është për bizneset? 4- Sa tonë mbetje të rrezikshme janë trajtuar	02.09.2024	Në përgjigje të kërkesës së ardhur administruar në AKM me Nr. 8930 Prot., datë 26.08.2024, ju bëjmë me dije si më poshtë, brenda fushës së veprimtarisë së AKM-së referuar VKM-së Nr.568/2019 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit": Menaxhimi i mbetjeve bëhet sipas përcaktimeve ligjore në ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe në lejet mjedisore përcaktohet mënyra e trajtimit të tyre. Bazuar ne Ligjin 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, te ndryshuar, si VKM-së Nr.402 datë 30.06.2021 “Për Miratimin e katalogut të mbetjeve”, Klasifikimi dhe emërtimi i kodeve të mbetjeve bëhet, sipas origjinës dhe përbërjes se tyre. Në Katalogun e mbetjeve, nga 953 specifikime kodi mbetje ne total, 418 prej tyre klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Në mbështetje të shtojcës 3 "Vetite e mbetjeve që i klasifikojnë ato si te rrezikshme", te ligjit te sipercituar, mbetjet e rrezikshme klasifikohen ne nendarje te tjera si shperthyese, oksiduese, irrituese, demtuese, te djegshme e me radhe. Mbetjet e rrezikshme sipas Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, te ndryshuar, trajtohen nëpërmejt procesit të rikuperimit, riciklimit dhe asgjesimit sipas metodave ligjore të përcaktuara. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim. Vendi yne nuk ka impianc incenerimi per mbetje te rrezikshme.	Përfunduar	Nuk ka

	<p>brenda vendit dhe sa janë eksportuar jashtë vendit nga 1 janari 2023-gusht 2024?</p> <p>5- Në rast se anijet MAERSK rezultojnë me mbetje toksike, ku do të shkojnë ato pasi të kthehen në Shqipëri? Çfarë do të ndodhë me ngarkesën e tyre?</p>				
--	--	--	--	--	--